



Procesverbal 09/2019

I mbajtur me datën 26.09.2019 në mbledhjen e IX-të rregullt të Komitetit për Komunitete, i udhëhequr nga z.Hajriz Haziri.

Mbledhja filloi në ora 11.00 h.

Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri – I përshëndeti të gjithë të pranishmit duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe e propozoi këto pika të rendi të ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrësve në mbledhjen e KK-ve;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
4. Pastrimi i deponive të ngurta në lagjet e komuniteteve dhe ndriçimi publik.
5. Të ndryshme.

Pika: 1

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri - Fillimisht e konfirmoi pjesëmarrjen e anëtarëve të K. Komuniteteve. Prezent janë të gjithë përpos Zenel Elanit i cili ka marrë leje.

Pika: 2

Miratimi i rendit të ditës:

Miratohet rendi i ditës nga të gjithë anëtarët.

Pika: 3

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar nga të gjithë anëtarët dhe Votohet procesverbali pa asnjë vërejtje.

Pika: 4

Pastrimi i deponive të ngurta në lagjet e komuniteteve dhe ndriçimi publik.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri – Sa i përket pastrimit të deponive të ngurta në lagjet e komuniteteve është folur shumë në këtë komitet, por tash veç është pastruar deponoja e materialeve të ngurta në fshatin Dubravë, ndërsa së shpejti pritet të pastrimit të deponive në lagjen “Halit Ibishi” dhe Lagjën Sallahane. Me vet kontribut banorët e fshatit Dubravë i kanë ble disa kamera dhe i kanë vendosur në vendin ku ka qenë deponoja me vëzhgim mos të hedhen mbeturinat.

Sa i përket ndriçimit veç kana filluar me vendosur drita.

z. Nexhat Kryeziu - Lidhur me pastrimin e e deponisë së mbeturinave të ngurta në fshatin Dubravë për neve po flitet se nuk po punojmë asgjë për komunitet edhe pse na vazhdimisht e kemi ngritur këtë çështje në komunitet lavdratën e ka marrë z.Qazim Rrahmani te banorët e fshatit. Është mirë që ne të reagojmë e mos t'i merr lavdatat e punës tonë dikush tjetër.

znj. Mimoza Pajaziti – Fillimisht i përshëndeti të pranishmit. Lidhur me këtë jemi dëshmitarë të gjithë sa kemi diskutuar dhe e kemi bërë atë që është e mundur ndërsa sa i përket lëvdatave kjo nuk është me rëndësi.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri - Nuk është me ia humbur meritat askujt sa do pak që na ndihmon.

znj. Fitore Lipovica – Ne e kemi ngritur çështjen mirë që i paskan hjekur mbeturinat dhe nuk është e rëndësishme kush lavdërohet.

z. Xhemajl Jashari – E jona është me e adresuar problemin e kush e kryen punën nuk është me rëndësi.

Pika: 5

Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri - Pasi nuk ka diskutime për këtë pikë e konsideroj mbledhjen e mbyllur.

Procesmbajtësi


Isuf Salih



Kryetari i Komitetit për Komunitet


Hajriz Haziri